



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK


Nr. _____ Prot.

Rrogozhinë, më 21.06.2024

NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Mërkurë datë 26.06.2024 ora 09:00^{oo}**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.8, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 03.06.2024.
- 3- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin në parim të Projekt-Studimit për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosore në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë”.
- 6- Miratim i projekt-vendimit, “Për shpalljen e emergjencës në rezervuarin e Domen, fshati Domen, Njësia Administrative Kryeviidh”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për një ndryshim në vendimin nr.37, datë 27.12.2023, ‘Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë për vitin 2024’ “, me qëllim përfshirjen në këtë vendim për caktimin e nivelit të pagave të Punonjësve të Policisë Bashkiake Rrogozhinë.
Shqyrtohet i njëjti projektvendim i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 03.06.2024.
- 8- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e projektit ‘Organizim eventit muzikor dhe humoristik në qytetin tonë për periudhën e stinës së verës datë 28 Korrik 2024’ “.
Shqyrtohet i njëjti projektvendim i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 03.06.2024.
- 9- Informacion mbi realizimin e treguesve ekonomikë të Njesisë së Ujësjellës - Kanalizime Rrogozhinë si dhe masat e marra për furnizimin normal me ujë të banorëve të Bashkisë dhe të zonave turistike (plazhi i Spillesë dhe i Vilë - Bashtovës) për periudhën Maj 2023- Maj 2024.
- 10- Raport nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore mbi punën e bërë nga ky Sektor për periudhën Qershor 2023- Qershor 2024.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

- 11- Raport nga Administratorët e Njësive Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Janar - Maj 2024.
- 12- Të ndryshme.
- *Shqyrtim i përgjigjes së drejtorisë së të ardhurave mbi rishikimin e Paketës Fiskale 2024, Tarifave Vendore për biznesin e vogël.*
 - *Shqyrtim i kërkesë ankesës së ardhur nga disa banorë të fshatit Zanbishë mbi zgjedhjet për kryesinë dhe kryetarin e fshatit.*
 - *Të tjera.*

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- **Njoftoj të mbledhet ditën e Martë datë 25.06.2024 ora 10 : 00^{oo}, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit**, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla -Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej-Anëtar.
- **Njoftoj të mbledhet ditën e Martë datë 25.06.2024 ora 10 : 30^{oo}, Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave**, me këtë përberje : Lulzim Hasa - Kryetar, Isa Halili Zëvendëskryetar, Fatmira Thartori - Anëtare, Altin Tosku - Anëtar, Hekuran Xhani - Anëtar.
- **Njoftoj të mbledhet ditën e Martë datë 25.06.2024 ora 11 : 00^{oo}, Komisioni Juridike, Rend, Konflikte**, me këtë përbërje : Mitat Daja - Kryetar, Indrit Dedej - Zv. Kryetar, Lulzim Hasa - Anëtar, Renato Kalemi - Anëtar, Merilin Saraçi - Anëtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI**